

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.336, DATË 31.05.2006 "PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimet në në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror" propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky projektakt është hartuar në kuadër të procesit të Deinstitutionalizimit, proces i cili ka filluar që me miratimin e Vendimit nr. 706, datë 09.09.2020, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit (PKD) 2020-2022, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Për të siguruar zbatimin e këtij plani kombëtar me Urdhër të Ministrit Nr. 548/2020, i ndryshuar u ngrit Komiteti Drejtues, me përfaqësues të të gjithë aktorëve pjesëmarrës në këtë proces, i cili, mori vendimin, janar 2023, për vijimësinë e Planit të Veprimit për Zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, për vitin 2023.

Në këtë kontekst, një nga nismat e ndërmarra në kuadër të vijimësisë së procesit të deinstitutionalizimit është pilotimi i planit të transformimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror për fëmijë 0-5 vjeç në Bashkitë Vlorë dhe Korçë (më poshtë IPSH), struktura e të cilave është e miratuar me Urdhrin Nr. 88, datë 25.10.2021 "Për miratimin e strukturës së Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar.

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror".

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË

Ky projektvendim nuk synon të përafrojë legjislacionin shqiptar me ACQUIS të BE-së. Në këtë kuptim, ndryshimet e propozuara nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti ka në përmbajtje dy pika.

Në pikën e parë të projektaktit parashikohet që togfjalëshi "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç" zëvendësohet nga togfjalëshi "Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes".

Në pikën e dytë janë parashikuar institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektakti.

Gjithashtu, në përmbajtjen e projektaktit është parashikuar hyrja në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

Me miratimin e projektaktit Bashkitë Korçë dhe Vlorë do të vijojnë me miratimin e strukturave dhe rregulloren e funksionimit e dy Qendrave të Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, me vendim të Këshillave Bashkiak.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHET PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror.



VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe po dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, pranë Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror".

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky vendim nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.


PROPOZUESI
MINISTËR
Albana Kociu


Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror".